



ADRIATIC

Zbatimi i përqsjes me bazë ekosistemet në
Detin Adriatik permes planifikimit hapësinor detar

Sigurojmë të ardhmen e burimeve detare të Adriatikut



Deti Adriatik është në udhëkryq. Burimet dhe ekosistemet detare të rajonit janë në rrezik, e po përballen me kërcënime ekologjike në rritje dhe presione të vazhdueshme nga të gjithë sektorët e ekonomisë blu. Një qasje e koordinuar - përtej kufijve dhe midis aktorëve që përfshijnë industrinë, peshkatarët, bizneset, përdoruesit dhe qeveritë - duhet të sigurojë përdorimet më të përshtatshme të detit, të zvogëlojë presionet dhe të arrijë një Status të Mirë Mjedisor për të gjithë Detin Adriatik.

Nëpërmjet përdorimit të përqsjes me bazë ekosistemet për planifikimin hapësinor detar (PHD), ne mund të ndërtojmë një të ardhme të qëndrueshme e afatgjatë për rajonin - dhe ky është synimi i projektit GEF Adriatic, mbështetur nga Fondi Global për Mjedisin.



PLANIFIKIMI HAPËSINOR DETAR DHE QËNDRUESHMËRIA

Pikërisht tani, është koha të ndërmarrim vendime të rëndësishme se si ta mbrojmë më mirë Detin Adriatik dhe të sigurojmë praninë e vazhdueshme të burimeve të tij natyrore. Projekti GEF Adriatic synon të mbështesë **Planifikimin Hapësinor Detar** në të gjithë rajonin, për një të ardhme të qëndrueshme, ku zhvillimi social ekonomik dhe mbrojtja e mjedisit janë në ekulibër. Kjo është e para nismë e këtij lloji, që përfshin **Programet e Integruara të Monitorimit dhe Vlerësimit** në kornizën e Planifikimit Hapësinor Detar për të arritur një **Status të Mirë Mjedisor**.

Megjithatë, Planifikimi Hapësinor Detar në rajonin e Adriatikut është zhvilluar vetëm kohët e fundit, dhe parimet dhe elementet e tij kryesore janë ende në zhvillim. Për të qenë i suksesshëm, ai duhet të operojë në një shkallë që përfshin të gjithë Detin Adriatik: Sfidat Ndërkufitare me të cilat përballemi kërkojnë një qasje me bazë ekosistemet.

QASJA ME BAZË EKOSISTEMET


Qasja me bazë ekosistemet nënkupton një vështrim të integruar, të drejtë dhe të qëndrueshëm të tokës, ujit dhe gjallesave të të gjithë rajonit. Ajo shkon përtej shqyrtimit të izoluar të problemeve specifike, specieve ose funksioneve të ekosistemit. Përkundrazi, ajo i shikon sistemet ekologjike ashtu siç janë: një përzierje e pasur elementësh në ndërveprim të vazhdueshëm.

Qasja me bazë ekosistemet është veçanërisht e rëndësishme për menaxhimin e zonave detare dhe bregdetare, në të cilat uji është elementi që i mban sistemet dhe funksionet tërësisht të ndërlidhura. Përfshirja e **qasjes me bazë ekosistemet** në

menaxhimin e Detit Adriatik nënkupton integrimin e plotë të biodiversitetit, peshkimit dhe ndotjes detare, si dhe proceseve hidrografike dhe ndërveprimet e tyre me bregdetin, në strategjitë dhe vendimmarrjen që udhëheq rritjen e ekonomisë blu.

Qëllimi kryesor i projektit GEF Adriatic është të nxisë përdorimin e qasjes me bazë ekosistemet në planifikimin hapësinor detar të rajonit. Duke na dhënë një kuptim të detajuar të funksioneve dhe ndërveprimeve të mjedisit detar, vlerësim të mundësive dhe matje të rreziqeve, projekti ndihmon planifikuesit të menaxhojnë zhvillimin e një ekonomie blu të qëndrueshme ndërsa synojnë një status të mirë mjedisor.

GEF ADRIATIC: QASJA ME BAZË EKOSISTEMET NË PHD



KËRCËNIMET KRYESORE




Turizmi i paqëndrueshëm

Presionet në rritje nga turizmi bregdetar dhe detar po prishin vlerat natyrore, të cilat janë atraksioni kryesor për vetë turistët



Mbipeshkimi

Menaxhimi i paqëndrueshëm i sasisë së peshkut vë në rrezik të ardhmen e këtij burimi



Ndotja

Mos trajtimi i ujërave të zeza dhe rrjedhjeve bujqësore po prishin cilësinë e ujit. Mbeturinat detare, të cilat po shtohen si nëpër plazhe ashtu edhe në det, si në sipërfaqe ashtu edhe në tërë kullonën e ujit e deri në fundin e detit, po dëmtojnë jetën e egër detare



Ndryshimet klimatike

Ngrohja e ujërave favorizon llojet nga vendet e ngrohta, të cilat kërcënojnë biodiversitetin lokal dhe dëmtojnë burimin kryesor të krijimit të ujit të dendur të Mesdheut, duke ndikuar kështu në tërë oqeanografinë detare. Ngritja e nivelit të detit kërcënon popullsinë në zonat bregdetare.

NË MBËSHTETJE TË VENDIMMARRËSVE RAJONALË

Projekti GEF Adriatic ka identifikuar zonat detare më me vlerë dhe më të brishta të Adriatikut, duke vëzhguar kapacitetet e tyre për të mbështetur rritjen e mëtejshme të sektorëve kryesorë ekonomikë, si:

- Peshkimi
- Akuakultura
- Turizmi detar (përfshirë ankorimin)
- Trafiku detar

Projekti ka identifikuar gjithashtu zonat më të kërcënuara nga ndotja, si dhe zonat të cilat përballen me ndikimet më të larta potenciale të rritjes së nivelit të detit, ndërkohë që shpalolet kriza e ndryshimeve klimatike. Ky informacion është thelbësor për autoritetet, pasi i ndihmon ata të planifikojnë masa zbutëse dhe përshtatëse.

Vizione dhe strategji, kuadër ligjor dhe institucional, mbledhje dhe strukturim i të dhënave, udhëzime, metodologji - të gjitha këto duhet të hartohen, dakordësohen dhe shpërndahen. Për të bërë këtë projekti GEF Adriatic po bashkon njerëzit - qeveritë, bizneset, komunitetet lokale, akademikët - po punon me shoqërinë civile dhe vendimmarrësit në rajon, si dhe organizatat ndërkombëtare si brenda dhe jashtë BE-së.

Deri më tani, projekti GEF Adriatic është përqendruar në Shqipëri dhe Malin e Zi, por mësimet e nxjerra nga projekti do të jenë të zbatueshme gjerësisht në rajonin e Mesdheut

DETI ADRIATIK NË SHIFRA

SIPËRFAQJA:
138,600KM²
VOLUMI:
35,000KM³

5%
E SIPËRFAQES SË
DETIT MESDH

7,000+
SPECIE TË FLORËS
DHE FAUNËS, ME
NUMËR TË LARTË
ENDEMIZMASH

49%
E TË GJITHE
SPECIEVE TË DETIT
MESDHE

10
MILLION
MILION NJERËZ
JETOJNË PËRGGJATË
VIJËS BREGDETARE

INFORMACIONE RRETH PROJEKTIT

- **EMRI I PROJEKTIT:** Zbatimi i qasjes me bazë ekosistemet në Detin Adriatik përmes Planifikimit Hapësinor Detar
- **KOHËZGJATJA:** maj 2018 - dhjetor 2020
- **VLERA:** 13,835,690 USD (Granti GEF 1,817,900 USD)
- **FINANCUAR NGA:** Grantet GEF, me kontribute nga vendet pjesëmarrëse dhe agjencitë zbatuese
- **AGJENSITË ZBATUESE:** UNEP/MAP në partneritet me PAP-RAC dhe SPA-RAC
- **VENDET PËRFITUESE:**
Shqipëri - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
Mali i Zi - Ministria e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Turizmit

“

“Ky është një projekt ambicioz dhe kompleks, i cili po demonstron se si mund të aplikohet qasja me bazë ekosistemet në planifikimin hapësinor detar. Falë bashkëpunimit të autoriteteve malazeze dhe shqiptare dhe gatishmërisë së tyre për të testuar bashkërisht qasjet inovative dhe të integruara në administrimin e burimeve detare, projekti ofron mundësi të mëdha për t’u aplikuar gjerësisht në tërë rajonin e Mesdheut”.

Lorenzo Paolo Galbiati
UNEP/MAP, manaxher projekti

“

“Mjedisi detar është një nga burimet tona më të rëndësishme kombëtare, por ne duhet të punojmë më fort për ta mbrojtur atë. Projekti na ofron një mundësi që nuk duhet humbur për të filluar menaxhimin e detit Adriatik në mënyrë të integruar për të arritur këtë qëllim. Shpresojmë që përvoja dhe të dhënat që do të gjenerohen nga projekti - veçanërisht përmes vëzhgimeve të vazhdueshme dhe monitorimit të detit – do të na japin një bazë solide për të ardhmen e planifikimit hapësinor në Shqipëri e më gjerë”.

Zamir Dedej
Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Shqipëri

“

Projekti GEF Adriatic do të japë një kontribut të madh në detyrimet tona për mbrojtjen e detit sipas Konventës së Barcelonës, dhe në përmbushjen e kërkesave të kandidimit në BE. Duke rritur ndjeshëm kapacitetet tona kombëtare për vlerësimin, monitorimin dhe menaxhimin e burimeve detare, projekti do të lejojë që Mali i Zi të fillojë për herë të parë proceset e planifikimit hapësinor detar në shkallë të gjerë.”

Ivana Stojanović,
Ministria e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Turizmit, Mali i Zi.

MË SHUMË INFORMACION

Projekti GEF Adriatic është ndërtuar mbi bashkëpunimin, dhe koordinatorët e projektit janë të prirur të rrisin vullmin e tij: ne jemi duke punuar me aktorë të ndryshëm për hartimin e politikave të ardhshme, mobilizimin e mundësive të financimit, fillimin e iniciativave të reja dhe shkëmbimin e praktikave më të mira. Cilido qoftë roli dhe përgjegjësia juaj, nëse jeni i përfshirë në menaxhimin e burimeve detare në Adriatik, ne duam të dëgjojmë nga ju.

Fondi Global për Mjedisin (GEF) është përqendruar në nxitjen dhe mbështetjen e menaxhimit të bazuar në zonë, duke ndihmuar institucionet rajonale të zgjedhin dhe zbatojnë politikat më efektive për të arritur objektivin global të ruajtjes së 10% të zonave detare në botë.

KONTAKT

Ivana Stojanović, Montenegro
 E: ivana.stojanovic@mrt.gov.me
 Zamir Dedej, Albania
 E: zamir.dedej@akzm.gov.al